



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën

Nr. 3458/ Prot.

Tiranë, më 10.11.2023

V E N D I M

Nr.45, datë 10.11.2023

PËR MARRJE MASE DISIPLINORE

Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën, në bazë të nenit 10/2 dhe nenit 65/2, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, në dt.10.11.2023 shqyrtoi kërkesën me:

Kërkues: Një grup prej 7 (shtatë) deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

Objekt: - Marrja e masës disiplinore ndaj deputetëve Saimir Koreshi, Lindita Metaliaj dhe Elda Hoti, sipas nenit 65/1, pika 1, gërma a) dhe pika 4, dhe neni 63, pika 1 gërma d), të Rregullores së Kuvendit dhe Kodit të Sjelljes së Deputetit, neni 3, pika dh) dhe ë) dhe nenin 8, pika 2, gërma b) dhe neni 33.

- Thirrja e Mbledhjes së Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën për vlerësimin dhe marrjen e masës disiplinore ndaj disa deputetëve.

Sekretariati u njoh me kërkesën e 7 deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste datë 10.11.2023 dhe u mblodh në bazë të njoftimit datë 10.11.2023 për mbledhjen e sekretariatit në datën 10.11.2023, në orën 15.00, në bazë të:

- Nenin 65/2, pika 1 të Rregullores që parashikon se “.... Mbledhja e sekretariatit zhvillohet brenda 48 orëve nga depozitimi i kërkesës”.
- Nenin 10, pika 5 e Rregullores që parashikon se: “...5. Rregullat e detajuara të funksionimit të sekretariateve, miratohen nga Byroja e Kuvendit”.
- Nenin 6, 7 dhe 8 të Rregullores “Për përcaktimin e Rregullave proceduriale të funksionimit të sekretariateve të Kuvendit të Shqipërisë”, miratuar me vendim të Byrosë së Kuvendit nr. 53, datë 13.05.2020, ku në nenin 6, pika 2, parashikohet se: “...2. Mbledhja e sekretariatit si rregull thirret nga sekretari i cili përcakton rendin e ditës, datën dhe orën e zhvillimit të saj. Njoftimi i sekretarit për thirrjen e mbledhjes shoqërohet me rendin e ditës si dhe me çdo akt, informacion apo dokument tjetër, i cili do të merret në shqyrtim apo që u shërben anëtarëve të sekretariatit për diskutim”; ndërsa në nenin 7, pika 1 përcaktohet se: “1. mbledhjet e sekretariatit janë të vlefshme kur në to

merr pjesë më shumë se gjysma e gjithë anëtarëve të sekretariatit....”, ku në nenin 8 (Publiciteti i mbledhjeve), pika 1, parashikohet se mbledhjet e sekretariatit zhvillohen të mbyllura.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët Klotilda Bushka, Aurora Mara dhe Klevis Xhoxhi, që përbëjnë kuorim e nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes. Dy anëtarët e tjerë të sekretariatit Saimir Koreshi dhe Bledion Nallbati, u njoftuan për thirrjen e mbledhjes; anëtari Bledion Nallbati nuk mund të merrte pjesë në mbledhje, në bazë të vendimit nr.43, datë 31.10.2023 të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën. Kolegu Saimir Koreshi nuk mori pjesë në mbledhje.

Gjithashtu, në bazë të nenit 65/2, pika 2 të Rregullores u thirrën për t’u dëgjuar deputetët ndaj të cilëve kërkohet marrja e masës disiplinore për shkelje të rënda të Rregullores së Kuvendit dhe Kodit të Sjelljes së Deputetit, të cilët nuk morën pjesë.

Mbledhja u krye në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik, platformës Zoom, sipas praktikave të mëparshme në bazë të rregullores së Kuvendit.

7 deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste në kërkesën e tyre për marrjen e masës disiplinore ndaj deputetëve Saimir Koreshi, Elda Hoti dhe Lindita Metaliaj lidhur me situatën e krijuar në seancën plenare të datës 09.11.2023, parashitrojnë se deputetët e opozitës me sjelljet e tyre në thyerje të rëndë të Rregullores së Kuvendit dhe të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kryen veprime për të penguar zhvillimin normal të seancës plenare duke futur dhe përdorur lëndë piroteknike (flakadanë) në sallën e Parlamentit.

Sekretariati diskutoi shkeljet e pretenduara bazuar në pamjet filmike të sallës së seancës plenare të datës 09.11.2023.

Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën, në vlerësim të sa parashitohet në kërkesën e 7 deputetëve, dhe pamjeve filmike që mori në shqyrtim dhe pas diskutimeve, vlerëson se kërkesa për marrjen e masave disiplinore ndaj tre deputetëve të opozitës është e drejtë dhe duhet pranuar.

Nga pamjet filmike rezulton se: deputeti Saimir Koreshi ka përdorur flakadanë tymues gjatë zhvillimit të seancës plenare; pretendohet se deputetët Lindita Metaliaj dhe Elda Hoti kanë futur në sallën e seancave plenare flakadanët tymues që i mbanin në cantat personale. Rezulton nga pamjet filmike se Saimir Koreshi flakadanët i merr në dy canta zonjash, (njëra ngjan në ngjyrë gri dhe tjetra në ngjyrë kafe) të vendosura në tryezat e deputetëve të krahut të opozitës në sallën e seancave plenare, dhe më pas i përdor këta flakadanë; tymi i flakadanëve përhapet rreth tij dhe në sallën e Kuvendit. Nga fotot që shoqërojnë kërkesën duket se dy çantat ku deputeti Saimir Koreshi merr flakadanët, i mbajnë dy koleget deputete ndaj të cilave kërkohet masë disiplinore (foto në hyrje të sallës së seancës plenare, bashkangjitur kërkesës). Këto veprime vijnë në shkelje të Rregullores së Kuvendit dhe Kodit të Sjelljes dhe kanë penguar zhvillimin normal të seancës plenare.

Për këtë arsye, sekretariati vlerëson se deputetët ndaj të cilëve kërkohet masa disiplinore kanë shkelur detyrimet e nenit 65/1, pika 1, germa a) të Rregullores së Kuvendit, pasi kanë kryer veprime që pengojnë zhvillimin e rregullt të seancës plenare si dhe nuk kanë respektuar nenin 3, germa dh) dhe ë), neni 8, pika 2 germa b) të Kodit Etik - Rregullat e Sjelljes në Kuvend.

Në fakt nga pamjet filmike të seancës plenare rezulton se që në nisje të seancës karriget e deputetëve janë hequr dhe me to është krijuar një barrikadë që pengon kalimin e deputetëve në foltore. Këto situata të ripërsëritura për bllokimin e veprimtarisë parlamentare janë anormale dhe pengojnë jo vetëm zhvillimin normal të seancës në shkelje të çdo norme të etikës parlamentare, por çënojnë dhe të drejtën e fjalës së deputetëve dhe ushtrimin normal të funksioneve kushtetuese në sallën plenare. Funksionimi normal i seancës plenare të Kuvendit prevalon mbi të drejtat e deputetëve, kur sjelljet e tyre vijnë në kundërshtim me Rregulloren dhe normat e Kodin e Sjelljes.

Sa më sipër Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën në zbatim të nenit 10/2, pika 2 dhe 5, nenit 63, pika 1, gërma d), nenit 65/1, pika 1, gërma a) dhe nenit 65/2 të Rregullores së Kuvendit dhe neni 8 të Kodit të Sjelljes së Deputetit, me unanimitet

V E N D O S I :

1. Marrjen e masës disiplinore “Përgjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 10 (dhjetë) ditë” për secilin nga deputetët Saimir Koreshi, Elda Hoti dhe Lindita Metaliaj, duke filluar nga data 13.11.2023 deri më datë 22.11.2023.
2. Ngarkohet “Shërbimi i Sigurisë në Kuvend” dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për zbatimin e këtij vendimi gjatë veprimtarisë parlamentare në Kryesinë e Kuvendit dhe në sallën e seancës plenare të Kuvendit.
3. Ky vendim mund të ankimohet nga deputeti brenda 2 (dy) ditëve pranë Byrosë së Kuvendit.

SEKRETARE

Klotilda BUSHKA

